

21.02.19
28.02.19



C.nr.1064/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Habib Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses [REDACTED], të cilën e përfaqëson me autorizim Zyra Ligjore e Avokatisë [REDACTED], avokatja, [REDACTED] kundër të paditurës Komuna e Ferizajt-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim [REDACTED] në çështjen juridike, për pagesën e pagave përcjellëse dhe jubilarë, në prezencën e të autorizuarit të pa paditësit dhe përfaqësuesit të paditurës, në shqyrtimin e mbajtur më 04 shkurt 2019, mori këtë:

AKT GJYKIM

- I. **APROVOHET** kërkesë padia e paditëses [REDACTED] nga Ferizaj, si e bazuar.
- II. **DETYROHET** e paditura paditurës Komuna e Ferizajt-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses [REDACTED] në emër të tre (3) pagave përcjellëse t'i paguaj shumën prej 1377.27 € (njëmijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e njëzetë e shtatë cent) si dhe në emër të tre (3) pagave jubilarë t'i paguaj shumën prej 1215 € (njëmijë e dyqind e pesëmbëdhjetë euro) të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënime të përmbarimit me dhunë.
- III. **OBLIOGOHET** e paditura që paditësit t'i paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 279 € (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënime të përmbarimit me detyruar.

Arsyetimi

Më datë 01.11.2018, në këtë gjykatë paditësja [REDACTED], përmes Zyrës Ligjore të Avokatisë [REDACTED] ka ushtruar padi, me të cilën ka kërkuar që ti aprovohet kërkesë padia ndaj të paditurës Komuna e Ferizajt-Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e 3 pagave përcjellëse dhe 3 pagave jubilarë pas pensionimit.

Lidhur me këtë Gjykata ka caktuar seancën gjyqësore më datë, 04 shkurt 2019, në të cilën paditësja përmes të autorizuarës së saj, ka kërkuar nga gjykata që ta aprovon kërkesëpadinë e paditësit, duke e obliguar të paditurën që t'i paguaj paditësit shumën 1377.27 € (njëmijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e njëzetë e shtatë cent) në emër të tre pagave përcjellëse dhe 1215 € (njëmijë e dyqind e pesëmbëdhjetë euro) në emër të tre pagave jubilarë, duke theksuar se paditësja i ka plotësuar kushtet ligjore për realizimin e kësaj të drejte, dhe atë mbi bazën Kontratës Kolektive e nënshkruar mes SBASHK-ut dhe MASHT-it, e cila ka hyrë në fuqi më 01.01.2015. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i të paditurës, në përgjigjen në padi por edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, i cili nuk ka paraqitur ndonjë pretendim konkret, përveç se ka sqaruar se pagat jubilarë nuk janë llogaritur nga paditësja ashtu siç përcakton Kontrata Kolektive, ngase paga bazë e paditësit ka qenë 405 €.

Për të vërtetuar gjendjen faktike, gjykata ka bërë ushtrimin e provave dhe atë janë lexuar: vendimi për përfundimin nga marrëdhënia e punës pas arritjes së moshës së pensionimit nr.1388 të datës 03.09.19 lëshuar nga Drejtoria e Arsimit-Komuna e Ferizajt, Listat e pagave për muajin dhjetor 2016, muajin janar dhe shkurt 2017.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditësit **është e bazuar**.

Gjykata, për këtë çështje nuk ka caktuar seancë përgaditore, por drejtpërdrejt ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, edhe pse në parim seancë përgaditore është e detyrueshme. Neni 401 i LPK-së-së, parasheh *''Seanca përgaditore është e detyrueshme, përveçse në rastet në të cilat gjykata.....nga shkaku i pandërlikueshmërisë së kontestit vjen në përfundim se nuk ka nevojë të konvokohet seanca përgaditore''*. Bazuar në faktin se, kërkesëpadia e paditësit ka të bëjë vetëm realizimin e pagave përcjellëse dhe pagave jubilarë, si dhe fakti se palët nuk kanë pasur propozime për paraqitjen e ndonjë prove tjetër, gjykata ka ardhur në përfundim se çështja nuk rezulton të jetë e komplikuar, andaj edhe është vendosur që të procedohet drejtpërdrejt në seancën e shqyrtimit kryesor.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësi ka arritur moshën e pensionimit më datë 26.02.2017, pastaj nuk ka qenë kontestuese përvoja e

punës 43 (dyzetë e tre) vjeçare, andaj duke pasur parasysh këto rrethana gjykata nuk i ka administruar provat për këto fakte, dhe rrjedhimisht të njëjtat nuk do të arsyetohen më gjerësisht.

Themelësia e kërkesëpadisë së paditësit, në aspektin ligjor buron nga Kontrata Kolektive e nënshkruar mes SBASHK-ut dhe MASHT-it, e cila ka hyrë në fuqi më 01.01.2015, e cila ka qenë në fuqi me rastin e pensionimit të paditëses.

Neni 36 paragrafi 10 i Kontratës Kolektive parasheh: *‘Punëtorët që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellësenë lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marrë për tre muajt e fundit. Ndërsa lidhur me kërkesëpadinë për pagat jubilarë, po ashtu kjo kontratë paragrafi 9.3 të po këtij nenin ‘Punëtorët që dalin në pension përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë.....për 30 vjet të përvojës së punës te punëdhënësit i fundit në vlerë të tri pagave bazë’.*

Andaj bazuar në këto arsye, gjykata ka vendosur për aprovimin e lartësisë, në emër të kompensimit për pagat përcjellëse dhe pagën jubilarë, ashtu siç janë të përshkruara në dispozitiv.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së, andaj obligohet e paditura që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 279 € (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë euro) dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104 (njëqind e katër euro) në emër të përfaqësimit shumë prej 135 € (njëqind e tridhjetë e pesë euro) si dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 40 (dyzetë e euro) të gjitha në afat prej në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënime të përmbaramit me detyruar.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

C.nr.1064/18 më 04 shkurt 2019

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOŠNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC



Gjyqtari,
Habib Zeqiri

Më
Dana 04.03 2019

KËSHILLA JURIDIKE, kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.

VENDIMI ËSHTË I EKZEKUTUESHËM
ODLUKA JE IZVRŠNA

Më dt. 12.03.2019 vit.
Dana _____ god.

Punëtori i autorizuar
Ovjačeni radnik